# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Viti një mijë e nëntëqint e nëntëdhjetë e katër.

Është Themelues:

- Ylli Senka
- Shtetas shqiptar me banim në qytetin e Lushnjes, lagja "Xhevdet Nepravishta".

Brënda identitetit të mësipërm është diskutuar dhe rënë dakort për të gjitha cështjet dhe është vendosur të përpilohet ky akt themelimi si marrëveshje për themelimin e SH.P.K.

- "SENKA".
- Mbështetur në principet e mëposhtëme.

I PARI

Formuesi do të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta emërtojë SH.P.K. "Senka" me administrator të vetëm Ylli Senkën.

I DYTI

Selia e shoqërisë do të jetë Lushnje lagja "Xhevdet Nepravishta". Me vendim të ortakut të vetëm mund të hapen seli sekondare, filia ose forma të tjera shoqërish, ashtu sikurse do ta shohë të arësyeshme orta

I TRETI

Kohë zgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat dhe mbi 10 vjet.

I KATËRTI

Objekti i shoqërisë do të formulohet me akt të vecantëtë ortakut dhe pasqyrohet gjërësisht në statutin e kësaj shoqërie që i bashkangjitet kë tij akti themelimi.

I PESTI

Kapitali social do të jetë 100.000(një qint mijë )lekë.

I GJASHTI

Shoqëria do të rregullohet përvec këtij akti themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin social, i cili do të nënshkruhet nga ortaku dhe si i tillë do të miratohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik.

O R T A K U

/ Ylli Senka /

## STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA.

Neni 1.

Shoqëria private "ZENKA" e poshtë shënuar shoqëri formohet nga themeluesi - Ylli Senka i biri i Osmanit me adresë në lagjen "Xhevdet Nepravishta" Lushnje.

Neni 2.

Shoqëria është person juridik dhe është krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tillë e fillon aktivitetin me rregjistrimin në rregjistrin tregëtar.

Neni 3.

Selia e shoqërisë është në Lushnje në lagjen "Xhevdet Nepravishta". Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, me zgjerimin e aktivitetit me miratim të ortakut.

Neni 4.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në përputhje me legjislacionin shqipëtar dhe me statutin e saj, në teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë filiale në vënde të tjera në përputhje me legjislacionin e vëndit përkatës.

Neni 5.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit të invenstuar në të.

LIBRI I SHOQËRISË

Neni 6.

Për të precizuar e për të përcaktuar veprimtarinë e vetë ekonomike dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të celë librin e vetë, i cili do të quhet libri i Shoqërisë.

KONFEDENCIALITETI

Neni 7.

Ortaku vetë, dhe për personat e punuar në shoqëri, bie dakort që të mos ekspozojë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhemen e saj.

Neni 8.

Të gjithë aktet dhe dokumentet e tjera që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët; si letra, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet SH.P.K kapitalin fillestar dhe emri i administratorit.

Neni 9.

Shoqëria ka si objekt të saj ndërtimin e objekteve të ndryshme, tregëtim materialesh ndërtimi me shumicë e pakicë,konsulencën që kërko het nga persona të ndryshëm juridikë e fizikë brënda e jashtë vëndit, hartime skicash planimetrike dhe të çdo lloji tjetër brënda vitit ndër timor,aktivitete biznesi.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 10.

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet,duke filluar nga data e rregjistrimit në rregjistrin tre gëtar,me përjashtim të rastit kur shkrihet para kësaj kohe,për shkaqe të arsyeshme,ose të zgjatjes së saj tej këtij kufiri,sipas rregullave të për caktuara më poshtë.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë.Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku Ylli Senka.Shoqëria mund të shtojë ose të pakësojë kapitalin e saj me miratim të ortakut themelues.

Neni 12.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndër mjet ortakëve(në qoftëse ka të tillë në të ardhmen). Gjithashtu pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen edhe të tretëve, me miratim të ortakut.Gjithashtu ato janë lirisht të transferueshme në raste ndarje pasurore mes bashkëshortëve si dhe në rrugë trashëgimnie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 13.

Shoqëria do të konsiderojë qëndrën e vet Lushnjen si Shoqëria Mëmë,i cili në rast pas rasti do të hapet edhe në filiale të tjera,ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha vëndet ku do të shikojë interes në përmbushjen e qëllimit të saj,në të gjithë teritorin e Republikës së Shqi përisë dhe jashtë saj.

Neni 14.

Organi më i lartë i shoqërisë është
- Administratori Ylli Senka.

Shoqëria mund të administrohet nga:një administrator unik i vetëm
- Aktualisht Ylli Senka.

nga një Këshill Administrativ

nga dy administratorë me një firmë të përbashkët ose të veçantë për sejcilin.

Neni 15.

Administratori ose administratorët E.q.s.do të ketë mund të jenë

ose jo ortakë sipas përcaktimit të ortakut. Administratori shkarkohet me vendim të ortakut ose kur jep vetë dorëheqjen.

Neni 16

Administratori unik ose si i autorizuar,i ka të gjitha kopetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë dhe në të gjitha rrethanat. Ai ka të drejtë të marrë pjesë në shitje,blerje, në procedurat e falimentimit,të hartojë kontrata të karaktereve të ndryshme,siguracione,të tjetërsojë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme,të hapë llogari rrjedhëse pranë bankës shqipëtare e të huaja, të depozitojë dhe të huajë para,të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët dhe në organet gjyqësore dhe administrative etj.

LIBRAT E SHOQËRISË,BILANCI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI.

Neni 17.

Shoqëria është e detyruar të mbajë përvec dokumentacionit kontabël ose librave të tjera edhe këto libra:

- Libri i ortakut në të cilin shënohet emri i plotë i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.

LIBRI I MBLEDHJEVE DHE I VEPRIMEVE TË ORGANIT VENDIMOR

-Libri i mbledhjeve dhe i veprimeve të organit administrativ.

BILANCI

Neni 18.

Bilanci mbyllet në 31 Dhjetor të cdo viti.

Llogaritë vjetore,inventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortaku Ylli Senka,miratohen nga ai, miratimi i këtyre dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

DIVIDENTET

Neni 19.

Pas miratimit të llogarive vjetore evidentimit të ekzistencës së fitimeve,përcaktohet pjesa që i takon ortakut themelues në firmë të dividenteve mbi fitimin. Ky fitim përbëhet nga fitimi i vitit financiar,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezervë të domosdoshëm të përcaktuar nga ortaku,të fondeve të tjera që shihen të nevojëshme dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparëshme.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 20.

Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar në statut me përjashtim të rasteve kur bëhet zgjatja e afatit me miratim të ortakut ose kur ka një prishje të parakohëshme për arësyet e parashikuara me ligj.

Neni 21.

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues të cilat i paraqesin atij raportin mbi gjëndjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë,mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.Në fund të procesit të likujdimit ortaku vendos mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar të kontribuesit përkatës(në se ka të tillë)likujduesi ndan kapitalin për ortakun themelues.

Neni 22.

MARRËDHËNIET PËR PUNËSIM

Kriteret e përgjithshme të punësimit të personave të tjerë,numurin e tyre,kufujtë e pagesës dhe detyrat e sejcilit në shoqëri përcaktohen nga ortaku i vetëm. Punësimi i personave në shoqëri kryhet mbi bazën e kontratës individiule të punës së hartuar sipas legjislacionit shqipëtar në fuqi.

Neni 23.

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimi dhe të sigurimave shoqërore,për të gjithë të punësuarit në të,ndërsa këta të fundit duhet të pranojnë këtë statut. Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe sipas këtij statuti për mos zbatim të detyrave dhe dëmeve që ato i shkaktojnë shoqërisë.

Neni 24.

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë,ose gjatë periudhës së likujdimit,që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tretëve do të tentohen të zgjidhen me mirëkuptim,në të kundërt do ti paraqiten për zgjidhje Gjykatës kopetente shqiptare konformë me legjislacionin Shqiptar.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25.

Shtimi i ortakëve

Kur ortaku i vetëm është dakort,dhe kur bordi drejtues i kësaj shoqërie me seli në Lushnje,është unanimisht dakort,që të bëhen shtesa kapitali me anë të personave të tjerë,që këta të konsiderohen ortakë duhet të veprohet kështu:

- së pari merret vendim nga ortaku i vetëm,ku shqyrtohet kërkesa e të interesuarit,bëhet pranimi dhe përcaktohet kuota e kapitalit që do të derdhë ortaku i ardhëshëm.

- së dyti bëhet rregjistrimi në librin e ortakut,ku shkruhet emri i plotë i ortakut të ri,dhe kuota në kapitalin social. Veprimi i bashkimit të ortakut të ri duhet të bëhet me akt noterial.

Nenë 26.

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve të mëtejëshme me anë amendamentesh sa herë që e sheh të arësyeshme ortaku themelues i këtij filiali, person juridik, me seli në Lushnje.

Ndryshimet e plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën bëhet vetë nxjerrje e këtij statuti.

Ndryshimet prekin personalitetin juridik të Shoqërisë.

Ky statut është hartuar në disa kopje në shqip, me fuqi të barabartë sejcila dhe pasi lexohet dhe gjëndet sipas vullnetit të palës nënshkruhet prej tij rregullisht.

ORTAKU I SH.P.K.

( Ylli Senka )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
N O T E R I A
Nr. 2099 Akt.
Nr. 602 Akt.

V Ë R T E T I M

Sot në datën 31. 5. 1994 para meje noterit Adrian Karoqe u paraqit deklaruesi Ylli Senka i biri i Osmanit, lindur dhe banues në Lushnje, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u njoha në bazë të dokumenteve përkatës i cili firmosi statutin e mësipërm me vullnetin e tij të plotë dhe të pavarur.

N O T E R I

/ Adrian Karoqe /